



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 09. 11. 2011, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Biserka Kostiq, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Duda Balje dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina Pula, Kurtan Kajtazi.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Bivolaku-EUSR, Ervin Ibrahim-UNDP, Florije Kryeziu-UNICEF, Elita Vokshi-OSBE, Ukë Gashi- ZPRK, Nuredin Ibishi- këshilltar i kryetares së Komisionit nga CDF, Isuf Zejna- KDI dhe Burim Tahiri- praktikant.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi Suazan Novoberdali, kryetare, e cila konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Propozimplani i veprimt të Kuvendit për vitin 2012 i Raportit të Progresit për Kosovën- detyrimet e Komisionit;
3. Njoftim i grupit të punës deri ku ka arritur puna në monitorimin e Ligjit për liritë fetare në Kosovë;
4. Njoftim i grupit të punës deri ku ka arritur puna për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Propozimplani i veprimit të Kuvendit për vitin 2012 i Raportit të Progresit për Kosovën- detyrimet e Komisionit

Kryetarja- Tha se koordinatori ka nxjerrë planin me të cilin ngarkohet Komisioni me veprimet që duhet t'i ndërmarrë për realizimin e tij. Gjithashtu i njoftoi anëtarët se plani i veprimit për shkaqe objektive nuk është i përkthyer në gjuhën serbe, prandaj lus Komisionin që të miratojë në parim, ndërsa në mbledhjen e radhës do ta kemi edhe versionin në gjuhën serbe.

Ajo pastaj tha se në Planin e veprimit për vitin 2012, është paraparë monitorimi i Ligjit kundër diskriminimit, ndërsa Ligji për barazi gjinore është në monitorim.

Kimete Bajraktari - Pyeti: A ekziston mundësia që në këtë plan të përfshihet edhe monitorimi i Ligjit për persona të zhdukur, pasi që ka rëndësi të veçantë dhe të informohemi për së afërmi me problemet që paraqiten rreth zbatimit të tij?

Rita Hajzeraj- Duke u ndërlidhur me diskutimin rreth monitorimit të Ligjit për persona të zhdukur, kërkoi nga Komisioni që të përfshihet në Planin e veprimit në tremujorin e dytë ose të tretë.

Pas një debati konstruktiv që u zhvillua lidhur me monitorimin e Ligjit për persona të zhdukur, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni vendosi që në Planin e veprimit për vitin 2012 të përfshihet monitorimi i Ligjit për personat e zhdukur.

3. Njoftim i grupit të punës deri ku ka arritur puna në monitorimin e Ligjit për liritë fetare ne Kosovë

Kryetarja- Kërkoi nga deputetja, Kymete Bajraktari, që ta informojë Komisionin me punën që është bërë deri më tani në përmbylljen e monitorimit të këtij Ligji.

Kymete Bajraktari- E njoftoi Komisionin se grupi i punës për monitorimin e Ligjit për liritë fetare, i ka kryer të gjitha punët rreth monitorimit, duke hartuar raportin përkatës. Prandaj, nëse dikush ka vërejtje apo plotësime lidhur me raportin, mund t'i sjellë propozimet në Komision, dhe pas shqyrtimit të tyre, nëse pajtohet Komisioni, ato mund të inkorporohen në raport. Më pas, ajo e njoftoi Komisionin me rekomandimet të cilat do t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim si në vijim:

Rekomandimi 1. Rekomandohet Zyra e Kryeministrit, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit përkatës, të rregullojë statusin juridik të bashkësive fetare në Kosovë.

Rekomandim 2. Rekomandohet Zyra e Kryeministrit, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit përkatës, të rregullojë çështjen e statusit pronësor – juridik të bashkësive fetare në Kosovë.

Rekomandimi 3. Rekomandohet Zyra e Kryeministrit, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit përkatës, të obligojë Ministrinë e Shërbimeve Publike që në formularët e regjistrimit të popullsisë civile të jenë të përfshira të gjitha bashkësitë fetare, të parapara me ligj.

Rekomandimi 4. Rekomandohet Zyra e Kryeministrit, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit përkatës, në mënyrë të qartë, të rregullojë kompetencat e bashkësive fetare.

Rekomandim 5. Rekomandohet Zyra e Kryeministrit, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit përkatës, çështja e bashkësive fetare në Kosovë të jetë e barabartë, të mos ketë diskriminim pozitiv ose negativ.

Rekomandim 6. Rekomandohet Zyra e Kryeministrit, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit përkatës nëpër komuna të formohen këshillat përkatëse për mbikëqyrjen e realizimit të të drejtave të bashkësive fetare në raport me institucionet shtetërore.

Rekomandim 7. Rekomandohet Zyra e Kryeministrit, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit përkatës, të zgjidhet edhe çështja e financimit të bashkësive fetare në Kosovë.

Rekomandim 8. Rekomandohet Zyra e Kryeministrit, që të krijojë mekanizëm ligjor për regjistrimin e grupeve fetare.

Kimete Bytyçi - Derisa ata kanë kërkuar financim, do të ishte mirë që kjo të rregullohet me statut të këtyre bashkësive fetare, unë jam e pajtimt që kjo çështje mos të lihet anash.

Kryetarja- Tani kemi disa rekomandime shumë të mira, nuk po i miratojmë tani, por do t'i kemi në shqyrtim serish në mbledhjen e radhës, dhe nëse nga anëtarët e Komisionit ka ndonjë kërkesë për ndryshim apo plotësim, do t'i inkorporojmë në raport.

4. Njoftim i grupit të punës deri ku ka arritur puna për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore

Kryetarja - Tha se, sa i përket monitorimit të këtij Ligji, kam punuar me Elita Vokshin nga OSBE-ja dhe deputeten Albana Gashi. Kemi marrë disa shembuj të Malit të Zi, ata kanë bërë një punë shumë të mirë në monitorimin e këtij Ligji, duke bërë një raport gjithëpërfshirës, ne do të mundohemi të bëjmë një raport më të detajizuar me pjesët kryesore. Gjithashtu, është mirë që të mendojmë se për monitorimin e këtij Ligji, të angazhojmë edhe ndonjërin prej organizatave të shoqërisë civile.

Rita Hajzeraj- Tha se nuk e shih të arsyeshme që kjo punë t'i besohet shoqërisë civile, sepse ata mund të kenë krejtësisht opinion tjetër nga Komisioni, më e arsyeshme është që t'i angazhojmë tre apo katër ekspertë në kuadër të Komisionit dhe të na ndihmojnë në monitorimin e këtij Ligji.

Kymete Bajraktari- Tha se ne kemi qasje në organizatat joqeveritare dhe të gjeturat që ata i kanë të evidentuara, ne si Komision mund t'i shfrytëzojmë dhe t'i përpunojmë statistikën e tyre.

Kryetarja- Tha se për këtë, ne vetëm debatuar dhe nuk po marrim ndonjë vendim. Kjo të mbetet si ide, do të shikojmë prapë se cila është rruga më e mirë dhe më e drejtë.

5. Të ndryshme.

Kryetarja- Njoftoi anëtarët e Komisionit se ka pranuar një kërkesë nga UNDP-ja, e cila dëshiron ta mbështesë Komisionin në disa aspekte, duke përfshirë edhe atë teknik, dhe për këtë, në emër të Komisionit falënderoi UNDP-në që ka shprehur gatishmërinë që t'na përkrahë në të gjitha kërkesat që Komisioni do të ketë nevojë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu